

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik “Princi Company” Sh.P.K. të datës 15.05.2024 kundër njoftimit mbi vendimin e datës 13.05.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Agjësimi i barnave dhe produkteve medicinale pa afat në objektet shëndetësore publike KPSH” me nr. të prokurimit 616-24-1750-2-1-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik “Princi Company” Sh.P.K. e datës 15.05.2024 kundër njoftimit mbi vendimin e datës 13.05.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Agjësimi i barnave dhe produkteve medicinale pa afat në objektet shëndetësore publike KPSH” me nr. të prokurimit 616-24-1750-2-1-1.
- II. **AUTORIZOHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të përcaktuar si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHET** operatori ekonomik “Princi Company” Sh.P.K. si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik “Princi Company” Sh.P.K. (tutje “parashtruesi”) me datë 15.05.2024 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin e datës 13.05.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Agjësimi i barnave dhe produkteve medicinale pa afat në objektet shëndetësore publike KPSH” me nr. të prokurimit 616-24-1750-2-1-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet ankimore të parashtruesit: "OE Met Bat Sh.P.K. i rekomanduar për dhënie me datën 13.05.2024 nuk posedon licensë për leje mjedisore për menaxhimin e mbeturinave. Leja mjedisore e integruar dhe e prezantuar në ofertë është leje e subjektit tjetër KMI Sh.P.K. subjekt aktiv sipas ARBK".

Lidhur me pretendimet ankimore duhet sqaruar se tenderuesi i rekomanduar ka dorëzuar me ofertën e tij ka dorëzuar ndër të tjera edhe vendimin e MMPH me nr. ref. 19/1765/246/DMMU për transferimin e lejes mjedisore nga KMI Sh.P.K. te kompania trashëguese "Met Bat" Sh.P.K. Këtij vendimi i ka bashkangjitur edhe letrën përcjellëse të vendimit si dhe letrën e distribuimit me numrin e njëjtë të referencës. Në figurën vijuese shih vendimin për transferimin e lejes mjedisore te Met Bat Sh.P.K.:



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

Zyra e Sekretarit të Përhershëm / Kancelarija Stalnoq Sekretara / Office of the Permanent Secretary

Në bazë të nenit 15 paragrafi 3, të Ligjit Nr.03/L-043 Për Parandalimin dhe Kontrollin e Integruar të Ndotjes dhe nenit 44. të LPA (Nr.05/L-031), Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, bie këtë:

VENDIM

APROVOHET kërkesa e Kompanisë "MetBat" shpk, Sankoc, Gllgoc për transferim të Lejes Mjedisore të Integruar nga "KMI" shpk, Sankoc, Gllgoc në "MetBat" shpk, Sankoc, Gllgoc


Arsyetim

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH), ka shqyrtuar kërkesën dokumentacionin e dorëzuar të kompanisë "MetBat" shpk, Sankoc, Gllgoc, për transferim të Lejes Mjedisore të Integruar të lëshuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, për kompaninë "KMI" SH.P.K., me Vendim të datës: 06.02.2019 dhe ZSP-6594/822/17/2017 për impiantin Asgjësimi i mbeturinave spitalore, medicinale, organike të përgjithshme në Sankoc, Gllgoc në ngastrën kadastrale nr.265/1 dhe 266/1, numri i lëndës së certifikatës 117, zona kadastrale Sankoc, Gllgoc.

Në bazë të nenit 15 paragrafi 3, të Ligjit Nr.03/L-043 Për Parandalimin dhe Kontrollin e Integruar të Ndotjes, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, miraton kërkesën për transferim të Lejes Mjedisore të Integruar, me Vendim të datës: 06.02.2019 dhe ZSP-6594/822/17/2017 impianti për Asgjësimin e mbeturinave

Faqe 2 nga 3

Adresa: Objekti i Ri Qeveritar, ish Pallati i Mediave "Rilindja" kati 17, nr. 1713 - 10000 Prishtinë, Kosovë
Telefon: + 381 38-200-32-307
<http://www.ks-gov.net/mmph>, E-mail: zsp.mmph@ks-gov.net



Faqe 2 nga 3

Adresa: Rr. "UÇK" nr. 2, Prishtinë 10000
Tel.: 038-200-40-111
Email: visar.shehu@rks-gov.net

spitalore, medicinale, organike të përgjithshme në ngastrën kadastrale nr.265/1 dhe 266/1, numri i lëndës së certifikatës 117, zona kadastrale Sankoc, Glllogoc, nga KMI SH.P.K. Sankoc, Glllogoc, me nr. certifikatës së regjistrit të biznesit 70445368 në "MetBat" shpk, Sankoc, Glllogoc, me nr. certifikatës së regjistrit të biznesit 810193368 si trashëguese e ardhshme e kësaj Lejes Mjedisore të Integruar për Implantin për Asgjësimin e mbeturinave spitalore, medicinale, organike të përgjithshme në Sankoc, Glllogoc në zonën kadastrale nr. 265/1 dhe 266/1, numri i lëndës së certifikatës 117, zona kadastrale Sankoc, Glllogoc.

Kompania trashëguese "MetBat" shpk, Sankoc, Glllogoc, është e obliguar që të i përmbahet rekomandimeve, obligimeve dhe ti përmbushë të gjitha kushtet e paraqitura në Lejen mjedisore të Integruar.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nxjerrjes.

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të inicioj konflikt administrativ me padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë në afat 30 ditësh nga dita e të të njëjtit.

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor

Nr. 19/1765/246 -ZSP- /233/19 datë 06.05.2019

Prishtinë



T'i dërgohet:

1. Parashtruesit të kërkesës
2. Komisionit për LMI
3. Inspektoratit
4. Kabinetit të Ministrit
5. Arkivit të MMPH-së

Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimi ankimor i parashtruesit sipas të cilit Met Bat Sh.P.K. nuk posedon leje mjedisore sikurse është kërkuar në DT, është pretendim i pabazuar pasi që sipas vendimit të MMPH të cituar më sipër është konfirmuar se tenderuesi i rekomanduar e përmbush në tërësi edhe këtë kërkesë të DT.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. nënparagrafin b) lidhur me nenin 62 par. 62.1. nënparagrafin d) të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik. Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 20.05.2024

Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.